

VENDIM
Nr. 26, datë 18.1.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
“TV ME KABËLL MEMALIAJ”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetar
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Gent Ibrahim	anëtar
Suela Musta	anëtare
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”.

BAZA LIGJORE: neni 7 pika 21, neni 33 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr. 540, datë 4.12.2006, ka vendosur të licencojë subjektin, person fizik, Vladimir Shehu, për subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”, për të mbuluar me sinjal televiziv qytetin Memaliaj. Afati i licencës së subjektit ka përfunduar në datën 22.12.2012.

KKRT-ja, me shkresën nr. 1392 prot., datë 12.10.2012, ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit të licencës, duke kërkuar nga ky i fundit depozitimin e aplikimit për rinovim licence. Pavarësisht njoftimit zyrtar të KKRT-së, nga ana e subjektit nuk është depozituar aplikim për rinovimin e licencës.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime financiare ndaj KKRT-së, pagesë vjetore për licencë për vitet 2010, 2011 dhe 2012, në masën 500.000 lekë.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 269 prot., datë 15.2.2010, nr. 64 prot., datë 14.1.2011, nr. 643 prot., datë 5.4.2011, nr. 704 prot., datë 14.4.2011 dhe nr. 196/35 prot., datë 2.2.2012, ka njoftuar zyrtarisht subjektin televiziv kabllor “TV me kabëll Memaliaj”, por pavarësisht këtyre njoftimeve subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së në masën 500.000 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 765 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1056 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave, duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. Kërkuesi ... nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

Në mbështetje të nenit 137/3 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, KKRT-ja për t’i dhënë mundësi të licencuarit të japë mendime, para marrjes së vendimit për heqjen e licencës, njofton të licencuarin për vendimarrjen përkatëse.

Në përfundim, KKRT-ja është e mendimit që subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”, t’i lihet një afat 30-ditor brenda të cilit të paraqesë pretendimet e tij lidhur me këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 048/ RTV kabllor të subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati